



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .06.2024

**MBLEDHJA Nr. 20,**  
**Datë 19.06.2024, ora 12:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 19.06.2024, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 19 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sha për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sha për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “GSA” shpk për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “FU-GEN” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “NOVA PROSPECT” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
6. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.05.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “BLUE 1” me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW”, i ndryshuar.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “SMART WATT” shpk dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ANËTARE E BORDIT**  
**Erjola SADUSHI**